

I. MODELET E LEJEVE TË DREJTIMIT TË VLEFSHME

Në Shqipëri janë dy modele lejedrejtimi të vlefshme:

1. Modeli i lejedrejtimi IV.2/A, i lëshuar nga 1 Korriku 2005 deri më 23 Janar 2017.

Ky model është i vlefshëm deri më 22 Janar 2027.

Ngjyra dominuese është ngjyra rozë.

Përmasat: lartësia 86.0 mm;

gjerësia 54.0 mm.

Materiali: plastik, polikarbonat, me jo më pak se 4 (katër) shtresa, me jetëgjatësi 10 (dhjetë) vjet.

Fig.2



2. Modeli i lejedrejtimi IV.2/A, i lëshuar nga 24 Janari 2017 e në vazhdim

Ky model lejedrejtimi është në përputhje me dispozitat e Aneksit I të Direktivës 2006/126/EC “Mbi lejet e drejtimit”.

Ngjyra bazë është ngjyra rozë e shoqëruar me blu të lehtë.

Përmasat: ISO /IEC 7810 formati: ID-1 85,60 mm x 53,98 mm.

Karakteristikat fizike të materialit janë sipas standartit ISO 7810 dhe ISO 7816-1: polikarbonat, me jo më pak se 4 (katër) shtresa, me jetëgjatësi jo më pak se 10 (dhjetë) vjet.

Fig. 3



Në faqen e pasme të lejedrejtimit gjendet legjenda (në modelin e mëparshëm ishte në të majtë poshtë) në gjuhën shqipe dhe angleze, e cila tregon qartësisht si lexohet lejedrejtimi. Në legjendë nuk janë të 12 numrat që tregojnë ku ndodhen të dhënat e lejedrejtimit, por vetëm disa prej tyre.

Më poshtë tregohen të dhënat që i korrespondojnë secilit numër në lejedrejtimi:

1. Mbiemri
2. Emri
3. Data dhe vendi i lindjes [Si vendlindje tregohet emri i shtetit dhe shenja dalluese e tij
p.sh: SHQIPËRI (ALB)]
- 4a. Data e lëshimit
- 4b. Data e përfundimit të vlefshmërisë
- 4c. Lëshuar nga
5. Numri i lejedrejtimit
6. Fotografia
7. Firma

9. Kategoria (të)
10. Data e kualifikimit (Data e lëshimit të çdo kategorie)
11. E vlefshme deri në (Data e përfundimit të vlefshmërisë të çdo kategorie);
12. Kodet [Informacion (e) shtesë/kufizim (e)].

Të dhënat nga numri 1 në numrin 9 tregohen në faqen e përparme të lejedrejtimit (numrat 6, 7 dhe 9 nuk tregohen në legjendë; numri 8 në modelin e mëparshëm (Fig.2), i cili i korrespondonte vendbanimit, në modelin e ri (Fig.3) është hequr; vendbanimi nuk shënohet më në lejedrejtimi; të dhënat nga numri 9, të cilin e gjejmë në të dy faqet e lejedrejtimit, deri tek numri 12, gjenden në faqen e pasme të lejedrejtimit.

Në kolonën 12 vertikal shënohen kodet e harmonizuara të BE-së që i përkasin çdo kategorie, ndërsa në fushën 12 horizontal tregohen kodet e harmonizuara që i përkasin mbajtësit të lejedrejtimit, mjetit dhe çështjeve administrative.